

Dita Botërore e Bishtajoreve 2022

Në kuadrin e garantimit të sigurisë ushqimore dhe të zhvillimit ekonomik botëror, rëndësia e resurseve gjenetike të bimëve për ushqimin dhe bujqësinë po rritet gjithnjë e më shumë. Resurset e bishtajoreve, si komponent i agrobiodiversitetit, janë shumë të rëndësishme për ushqimin, prodhimin bujqësor të qëndrueshëm dhe sigurimin e jetesës së një pjese të madhe të popullsisë e cila merret dhe jeton me bujqësi.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), pas një pune të rëndësishme për të përshkruar rëndësinë sociale, ekonomike dhe ushqyese të bishtajoreve, caktoi për t'u shënuar viti 2016 si "Viti Ndërkombëtar i Bishtajoreve". Për këtë qëllim OKB emëroi **Organizatën e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)** për të ndihmuar në miratimin e këtij viti në bashkëpunim me të gjitha qeveritë dhe organizatat.

Dita synon të formulojë një zinxhir komunikimi, tregtie dhe ushqimi midis vendeve përmes kombeve të bashkuara. **Dita Botërore e Bishtajoreve**, e organizuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) e Kombeve të Bashkuara, është një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet ushqyese të bishtajoreve dhe kontributin e tyre në sisteme të qëndrueshëm të ushqyerit.

Bazuar në suksesin e Vitit Ndërkombëtar të Bishtajoreve në 2016 të udhëhequr nga FAO, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dhjetor të vitit 2018, caktoi për të festuar për çdo vit *një ditë që mund të shprehë vlerën dhe përfitimet* nga bishtajoret. Pasi rekomandimet e OKB-së u duartrokitën përmes Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), **data 10 shkurt** u caktua dhe u vendos përfundimisht si një ditë ndërkombëtare e bishtajoreve. Kështu më 10 shkurt 2019 u festua për herë të parë Dita Botërore e Bishtajoreve.

Dita Botërore e Bishtajoreve 2022, është të enjten më 10 shkurt 2022. Dita Botërore e Bishtajoreve festohet çdo vit më 10 shkurt dhe në vitin aktual 2022, është hera e katërt e festimit të Ditës Botërore të Bishtajoreve.

Tema e Ditës Botërore të Bishtajoreve "*Farat ushqyese për një të ardhme të qëndrueshme*" u përcaktua si një slogan që u formulua në vitin 2016, pas emërimit të këtij viti si Viti Ndërkombëtar i Bishtajoreve. Ky vit specifikoi dhe theksoi rëndësinë ushqyese të bishtajoreve dhe që atëherë është shpallur si *temë në vazhdimësi* e festimit të Ditës Botërore të Bishtajoreve.

Tema e Ditës Botërore të Bishtajoreve 2022 do të jetë: "*Bishtajoret për të fuqizuar të rinjtë në arritjen e sistemeve të qëndrueshme agroushqimore*".

Kombet e Bashkuara kanë përcaktuar 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm dhe për hir të prosperitetit të njerëzimit, ka përgjegjësi që njerëzit të dinë se një ndër objektivat prioritare që duhet të përmbushet është edhe Dita Botërore e Bishtajoreve. Dita Botërore e Bishtajoreve, bie në kategorinë e **2^{te}** të objektivave prioritare të Kombeve të Bashkuara që titullon "Zero uri" në planet dhe përcakton më tej moton e saj për të prodhuar burime të tilla në bujqësi që mund të na ndihmojnë të zhdukim urinë dhe varfërinë. Gjithashtu, rëndësia e ditës botërore të bishtajoreve, lidhet me objektivin e **3^{te}** "*shëndet dhe mirëqenie të mirë*" dhe me objektivin e **13^{te}** "*veprim klimatik*" të Kombeve të Bashkuara të përfshira në Axhendën e saj 2030.

Qëllimi themelor i ditës botërore të bishtajoreve është një qartësi universale për nevojën dhe rëndësinë e bishtajoreve si një produkt ushqimor organik, i përbalueshëm dhe ekonomik, i cili jo vetëm që mund të na sigurojë shëndet më të mirë dhe lëndë ushqyese të rëndësishme dhe të mjaftueshme, por gjithashtu të na japë një mbështetje të mirë financiare përmes komercialitetit.

Një qëllim tjetër, për të festuar këtë ditë, është se, megjithëse përparimi teknologjik në bujqësi ka sjellë një rritje të arsyeshme të shkallës së prodhimit të bimëve, nevojat aktuale të shoqërisë kërkojnë që të prodhohen kultura që mund të ndihmojnë gjithashtu mjedisin tonë. Bishtajoret kanë një vlerë më të lartë të azotit se shumë bimë të tjera, gjë që ndryshe nga kulturat e tjera, e bën tokën më pjellore dhe me mundësi potenciale për rritje të mirë të bimëve në vitet e njëpasnjëshme.

Bishtajoret janë veçanërisht të rëndësishme për prodhimin e qëndrueshëm të bimëve, ato luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e pjellorisë së tokës dhe kanë një ndikim pozitiv në mjedis. Si një burim proteinash, bishtajoret janë veçanërisht të rëndësishme për dietat e shëndetshme. Bishtajoret, gjithashtu, kontribuojnë në krijimin e mundësive të jetesës dhe barazisë.

Kriza e vazhdueshme e klimës thekson më shumë se kurrë nevojën për të diversifikuar sistemet agro-ushqimore në mënyra më inteligjente për rritjen e prodhimit të ushqimit, forcimit të zinxhirëve të furnizimit dhe përmirësimin të dietave, veçanërisht për fermerët familjarë dhe konsumatorët me të ardhura të ulëta, që jetojnë në rajone të varfër. Në këtë këndvështrim, *bishtajoret janë kritike në adresimin e sfidave të diversifikimit të prodhimit*, uljen e varfërisë, rritjen e sigurisë ushqimore, shëndetit të njeriut dhe shumë-llojshmërisë së të ushqyerit, shëndetësimin të tokës dhe mjedisit, etj. Ndryshimet klimatike, janë një çështje e nxehtë sot, ku për shkak të mungesës së kapacitetit riprodhues të kulturave tona, azoti konsumohet dhe thatësia e tokës rritet. Bishtajoret kanë karakteristikën për të prodhuar vetë lëndë minerale dhe azot dhe për këtë arsye janë miqësore me mjedisin edhe me oksigjenin.

Qëllimi i festimit të kësaj dite është gjithashtu të ndërjegjësojë njerëzit me faktin se bishtajoret janë miqësore me njerëzit, janë të pasura me proteina, kanë një përqindje më të lartë të fibrave dhe përmbajnë lëndë ushqyese thelbësore, ku që të gjitha këto janë të nevojshme për një mënyrë jetese të shëndetshme. Për më tepër, kjo ditë trajton aspektet e bishtajoreve si një pjesë natyrale, organike dhe thelbësore të një shëndeti të mirë, natyrën miqësore të tyre për tokën me pasurimin me azot që në fund të fundit përcakton veprimin klimatik. Prandaj kjo ditë përforcon dhe improvizon një gamë të gjerë motivesh për të arritur në të ardhmen.

Prof. Dr. Belul Gixhari
Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve
Universiteti Bujqësor i Tiranës

04. 02.2022